

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
“SWEET COIN ” SH.P.K

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“SWEET COIN”** Sh.p.k, është themeluar në bazë të aktit të themelimit sipas Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 “për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ i ndryshuar me Ligjin Nr 10475, datë 27.10.2011 dhe me Ligjin 129/2014 si dhe në Ligjin 9723. Datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit “ i ndryshuar me Ligjin Nr 9916, datë 12.05.2008, me Ligjin Nr. 92/2012, datë 27.09.2012, dhe me Ligjin Nr.8/2015 datë 19.02.2015 si dhe në Përputhje me legjislacionin në fuqi;

Neni 1

Themeluesit e Shoqërisë

Themeluesit e Shoqërisë “SWEET COIN” janë:

- **Sokol Kodra**, lindur në Gjirokaster më 12.03.1981, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plota dhe juridike për të vepruar, mbajtës I letërnjoftimit me nr.personal I10312025R;
- **Ilir Bregasi**, lindur në Vlorë më 30.04.1989, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plota juridike dhe për të vepruar, mbajtës I letërnjoftimit me nr.personal I90430003P;
- **Denis Kaloshi**, lindur në Tiranë më 22.02.1997, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plota dhe juridike për të vepruar, mbajtës I letërnjoftimit me nr.personal J70222050G;

Neni 2

Emri i Shoqërisë

Është themeluar shoqëria **“ SWEET COIN” Sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.**

Neni 3

Selia

Selia kryesore e shoqërisë do të jetë në Tiranë me adresë , Rruga; “Marko Bocari”, Tirane.

Neni 4

Objekti



Shoqëria “**SWEET COIN**” sh.p.k, do të ketë si objekt të veprimtarisë:

- Tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore, lende e parë etj;
- Prodhim, tregtim dhe import/eksport, të laboratorëve të industrisë së ushqimit dhe aksesorëve përkatës, produkte të ndryshme ushqimore, pije alkolike, te gazura etj;
- Shoqëria mund të lejojë cdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të saj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria “**SWEET COIN**” sh.p.k, kryen veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga asambleja e shoqërisë.

Neni 6

Drejtimi

Organet drejtuese të shoqërisë janë;

1. Asambleja e përgjithshme që përbëhet nga themeluesit e shoqërisë;
2. Administratori;

Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë që emërohen për një periudhë prej 5(pesë) vjecare.

Administrator i shoqërisë do të jetë:

Sokol Kodra, lindur në Gjirokaster më 12.03.1981, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plota dhe juridike për të vepruar, mbajtës I letërnjoftimit me nr.personal I10312025R

Neni 7

Kapitali

Kapitali fillestar i shoqërisë do të jete 100 lekë (njëqind lekë).

- **Sokol Kodra**, lindur në Gjirokaster më 12.03.1981, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plota dhe juridike për të vepruar, mbajtës I letërnjoftimit me nr.personal **I10312025R**, do të zotëroje 1(një) kuote me vlere **58%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Ilir Bregasi**, lindur në Vlorë më 30.04.1989, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plota juridike dhe për të vepruar, mbajtës I

letërnjoftimit me nr.personal **I90430003P**, do të zotërojë 1 (një) kuotë me vlerë **32 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- **Denis Kaloshi**, lindur në Tiranë më 22.02.1997, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plota dhe juridike për të vepruar, mbajtës I letërnjoftimit me nr.personal **J70222050G**, do të zotëroje një kuote me vlere **10 %** te kapitalit themeltar të shoqërisë;

Neni 8

Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me ditën e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar të shoqërive dhe mbyllet me 31 Dhjetor 2024

Neni 9

Të tjera

Shoqëria krijohet dhe do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi. Ligji 9901, datë 14.04.2008 I shoqëruar me shtesa dhe ndryshime nr. 129/2014, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligje të tjera që do të jenë në fuqi gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë.

Ky akt themelimi është i hartuar në tre ekzemplarë, pasi u lexua nga themeluesi i shoqërisë dhe u gjet konform vullnetit të tyre të plotë, firmoset rregullisht me datë 12/04/2024.

THEMELUES

Sokol Kodra

SOKOL KODRA

Ilir Bregasi

Ilir Bregasi

Denis Kaloshi

Denis Kaloshi

